




Republika E Kosovës  
Republika Kosova  
Republic Of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## KONTRATË PUNE

**Komuna e Kaçanikut, përfaqësuar nga z. Shefket Koxha, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe**

**Shpk "KEMA COMPANY", nga Lipijani përfaqësuar nga i autorizuar Burhan Kolshi (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:**

### **Ndërtimi i trotuarit në rrugën Bob- Doganaj**

me numër identifikues: **KA652/20/038/521**

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

### **Ndërtimi i trotuarit në rrugën Bob- Dogana**

në < sipas dosjes > pjesë

#### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total është **47,995.93 €**,

dhe me fjalë (Katërdhjetëeshtatë mijë nënqindë nën dhjetë e pesë euro e 93/100 centë)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për pranim të punëve.

#### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;

- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

#### Për Kontraktuesin

#### Për Autoritetin Kontraktues

<b>Emri:</b>	Burhan Kolshi	<b>Emri:</b>	Shefket Koxha
<b>Pozita:</b>	Menaxher	<b>Pozita:</b>	Menaxher i Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	23.07.2020	<b>Data:</b>	2020
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

**PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>[SHQIPE]</b> .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <b>[shëno shumat]</b> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <b>[shëno shumat]</b> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <b>[shëno shumat]</b> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <b>[shëno shumat]</b> (ii) të personave të tjerë: <b>[shëno shumat]</b>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>[shëno numrin]</b> ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>[shëno numrin]</b> ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: <b>Arian Teneqja</b>
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë prej <b>24.07.2020</b> ku e gjith plani artohet në ditarë ndërtimor.
	10.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <b>brenda 50 ditëve</b> .
Përmirësimi i defekteve	13.1	Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë (një vit) nevlere prej 10 % të vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>[shëno numrin]</b> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>[0.25 %]</b> për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha

		Punët është 20 %] e Çmimit final të Kontratës.
Kushtet e pagesës	20.1	<b>Kushtet e pagesës janë:</b> Punëdhënësi pajtohet ta paguaj kontraktuesin në baze të punëve të kryera dhe pas raportit me shkrim nga ana e menagjerit që do të bënë përcjelljen e ekzekutimit të punimeve si dhe pagesa përfundimtare kryhet në bazë të raportit të menagjerit dhe raportit të komisionit për praninë të punëve .
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>[shëno përqindjen]</b>
Siguria e ekzekutimit	22.1	<b>Shume e sigurisë së ekzekutimit është 4,799.59€</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>[shëno përqindjen]</b> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Cdo mosmarrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore, në rast se nuk zgjidhet në mënyrë miqësore kompetente është Gjykata komunale Kaçanik.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<b>[shëno te dyja]</b> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatës Komunale Kaçanik</b> b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</b> në pajtim me <b>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</b>

Paramasa dhe Paralogaria					
E punëve për vazhdimin e ndërtimit të trotuarit në rrugën Bob-Doganaj					
I. Punët e demolimit dhe pastrimit					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1	Pastrimi i terrenit, prerja e drunjëve, demolimi i kubëzave ekzistuese, largimi i rrethojave etj. Në llogari hyn edhe transporti i materialit deri në deponi.	m'	1,700.00	0.10	170.00
<b>Gjithsej I:</b>					<b>170.00</b>

II. Punët tokësore					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV, duke përfshirë edhe humusin, me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi deri 15km, këtu hyn edhe gërmimi për hapjen e themeleve të mureve mbrojtëse dhe të tombinave.	m <sup>3</sup>	1,700.00	0.70	1,190.00
2	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës deri në modulën e ngjeshmërisë 40 MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	3,400.00	0.05	170.00
<b>Gjithsej II:</b>					<b>1,360.00</b>

III. Punët e zhavorit					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1	Furnizimi dhe punimi i mbushjes dhe stabilizimi me material guror jokohërent, shtrirje në shtresa dhe ngjeshje me CBR>15%, Moduli i ngjeshmërisë të jetë së paku 50 Mpa.	m <sup>3</sup>	400.00	1.50	600.00
2	Sigurimi i materialit, transporti dhe punimi i shtresës së tamponit prej zhavorit 0-63 mm. Moduli i ngjeshmërisë të jetë së paku 50 Mpa.	m <sup>3</sup>	612.00	3.00	1,836.00
3	Sigurimi i materialit, transporti dhe punimi i shtresës së tamponit prej zhavorit 0-31.5 mm. Moduli i ngjeshmërisë të jetë së paku 50 Mpa.	m <sup>3</sup>	306.00	4.00	1,224.00
<b>Gjithsej III:</b>					<b>3,660.00</b>

IV. Punët e kubëzave të betonit					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1	Sigurimi, transporti dhe montimi i gurëve skajor 18/24/100 cm, të klasës "T" sipas standartit EN1340:2003. Në llogari hyn edhe punimi i bazës prej betoni C25/30 me trashësi 10cm dhe sigurimi me beton ndaj prapëtimit.	m'	1,700.00	5.00	8,500.00
2	Sigurimi, transporti dhe montimi i gurëve skajor 08/20/100 cm, të klasës "T" sipas standartit EN1340:2003. Në llogari hyn edhe punimi i bazës prej betoni C25/30 me trashësi 10cm dhe sigurimi me beton ndaj prapëtimit.	m'	1,700.00	3.30	5,610.00



3	Sigurimi, transporti dhe montimi i kubëzave të betonit me trashësi t=8 cm. Në llogari hyn edhe rëra Fr II(4-8mm) me trashësi 3-5cm për nivelizim, ngjeshja e pllakave pas montimit, mbushja e fugave me rërë 0-4mm dhe pastrimi përfundimtar i tyre. Dizajni dhe modeli i kubëzave caktohet nga organi mbikëqyrës. Kubëzat duhet të plotësojnë kërkesat e soliditetit sipas standartit EN 1338:2003, EN1340:2003	m <sup>2</sup>	2,550.00	7.30	18,615.00
<b>Gjithsej IV:</b>					<b>32,725.00</b>

<b>V. Punët e betonit dhe armaturës dhe të lëshesave</b>					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma
1	Furnizimi dhe punimi me gur të thyer për drenazhim pas mureve të tombinës	m <sup>3</sup>	18.00	15.00	270.00
2	Furnizimi dhe vendosja e betonit për betonimin e mureve mbrojtëse dhe zgjerimit të lëshesave pllakore, klasa e betonit C 25/30. Të përfshihet edhe punimi i pahive të zakonshme.	m <sup>3</sup>	68.45	45.00	3,080.25
3	Furnizimi, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave duhet të bëhet sipas formave të paraqitura në detalet teknike si dhe të verifikohen në vendpunishte para betonimit. Vlera karakteristike e kufirit të rrjedhjes së çelikut (yield strength characteristic value) fyk=500 N/mm <sup>2</sup> , B500	kg	3,713.08	0.45	1,670.88
4	Furnizimi dhe punimi i parrakëve mbrojtës nga profilet metalike me profil rrethor gyp φ60mm me trashësi 2.5mm, shtyllat vendosen në distancë çdo 2cm dhe tri profile horizontale, profilet ngjyrosen me ngjyrë dy shtresa (parangjyrë dhe ngjyrë) në çmim parashihen edhe kthesat e profileve të parafabrikuara dhe elementet për ankerim të shtyllave.	m'	20.00	15.00	300.00
5	Sigurimi i materialit dhe betonimi i pjesës në mes të mureve mbrojtëse dhe kubëzave të betonit.	m <sup>3</sup>	25.50	30.00	765.00
6	Vazhdimi disa lëshesave në çmim përfshihen punët e gërmimit, zhavoriti për mbulimin e gyp dhe gypi φ315 HDPE, dhe koka hyrëse nga betoni	m'	24.00	7.00	168.00
7	Ngritja e pusëve dhe furnizimi dhe montimi i kapakut metalik me aftësi mbajtëse 25ton	copë	2.00	40.00	80.00
<b>Gjithsej V:</b>					<b>6,334.13</b>

<b>VI. Punët e ndriçimit publik</b>					
Nr.	Lloji i punëve	Nj.m.	Sasia	Ç.nj.	Shuma



1	Gërmimi i dheut i kategorisë III-IV për hapjen e kanalit me dimensione 0.4x0.6m me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi deri 15km, për vendosjen e kabllave dhe gypave PVC dhe mbyllja e kanalit pas shtrirjes së kabllave	m <sup>3</sup>	408.00	0.60	244.80
2	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e teres së imet fraksion 0-4 mm në trashësi d=0.2m në kanalim e hapur për mbrojtjen e tubit brinjor dhe kabllot të depërtuar në të cilin detajet	m <sup>3</sup>	136.00	2.00	272.00
3	Porositja, transporti dhe montimi i gypit të brinjëzuar PVC, FI 50	m'	1,700.00	0.50	850.00
4	Porositja, transporti dhe montimi i shiritit për vërejtje nga PVC me gjerësi 60mm	m'	1,700.00	0.20	340.00
5	Furnizimi dhe shpërndarja e shiritit të zinkuar FeZn (25x4)mm për krijimin e rrjetës së përtokëzimit.	m'	1,700.00	1.20	2,040.00
<b>Gjithsej VI</b>					<b>3,746.80</b>

REKAPITULIM(PUNËT NDËRTIMORE)		
I.	Punët e demolimit dhe pastrimit	170.00 €
II.	Punët tokësore	1,360.00 €
III.	Punët e zhavorit	3,660.00 €
IV.	Punët e kubëzave të betonit	32,725.00 €
V.	Punët e betonit dhe armaturës	6,334.13 €
VI.	Punët e ndriçimit publik	3,746.80 €
<b>Totali:</b>		<b>47,995.93 €</b>

Vërejte!	
Të gjitha çmimet e pozicioneve janë të llogaritura me TVSH.	
Në të gjitha pozicionet nënkuptohet furnizimi dhe transporti i të gjitha materialeve duke e llogaritur edhe punën për realizimin e pozicionit, më të gjitha elementet përcjellëse.	
Të gjitha materialet para përdorimit duhet të prezentohen për miratim nga organi mbikqyrës.	
Punëkryesi duhet që me kujdes të realizoj punën, pasi për çdo dëmtim të instalimeve (ujësjellësit, kanalizimit, rrymës, etj.), i bartë shpenzimet për rregullimin e defekteve eventuale.	
Punëkryesi i bartë shpenzimet për të gjitha atestet e materialeve dhe ekzaminimeve të cilat nevoiten në këtë rast dhe atestet dhe ekzaminimet shtesë të cilat kërkohen nga organi mbikqyrës.	
Gjatë punimeve punëkryesi është i obliguar të vendos shenjat për punime në rrugë.	

